



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:258030

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05743800

C.nr.4305/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Edije Sezairi, me bashkëpunëtorin profesional A.K. në çështjen juridike kontestimore të paditëses A.A. nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës M.A.Sh.T - A.A.P.A.Rr. me objekt kontesti kompensimin e inflacionit në pagë, vlera e kontestit 248.11 euro, me datë 28.05.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M
Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.A. nga Prizreni dhe **DETYROHET** e paditura M.A.Sh.T.- A.A.P.A.Rr. që paditëses, në emër të pagesës së inflacionit në pagë nga data 01.07.2022 deri më 20.11.2022, t'ia kompensoj shumën e përgjithshme prej **248.11 euro**, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë me datë 13.11.2023, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura, që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej **124.00 euro**, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja A.A. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të saj av. A.H. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate me datë 13.11.2023, ka parashtruar padi kundër të paditurës M.A.Sh.T.- A.A.P.A.Rr. me objekt kontesti kompensimin e inflacionit në pagë, ndërsa me parashtrësën e datës 03.04.2024, ka precizuar kërkesëpadinë duke kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit për periudhën kohore nga data 01.07.2022 e deri me datën 20.11.2022 në shumën prej 248.11 euro.

Në referatin e padisë ka theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune pranë Qendrës së Kompetencës në Prizren, mësimdhënëse dhe atë me kontratë pune në kohë të pacaktuar, bazuar në nenin 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë, mirëpo e paditura këtë kompensim nuk i ka paguar paditësit deri më tani. Ka theksuar se në vitin 2022 mesatarja e inflacionit në vend ka qenë 11.6%.

Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësit vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar. Ka theksuar se sipas nenit 90 para.4 të Ligjit të Punës “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”. Po ashtu bazuar në nenin 341 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve përcaktohet “Me parashkrim shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit. Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit. Gjykata nuk mund të merr parasysh parashkrimin, në qoftë se debitori nuk thirret në atë”. Po ashtu bazuar në këtë dispozitë ligjore MASHT-AAAPARR konsideron se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë nr.01B/2056 e datës 18.04.2017 është shfuqizuar në bazë të nenit 47 të Kontraës Kolektive e Arsimit në Kosovë nr.01B/105 e datës 22.01.2021, gjithashtu bazuar edhe në faktin se MASHT me datën 21.11.2022 është tërhequr nga Kontrata Kolektive nr.prot.01B/105 e datës 22.01.2021 e Arsimit në Kosovë dhe si e tillë kjo kontratë nuk mund të zbatohet. Në fund ka theksuar paditësi me asnjë provë të vetme nuk ka dëshmuar se ishte anëtar i SBASHK-ut, ashtu siç parashihet në dispozitën ligjore të nenit 35 par.8 dhe 9 të Kontratës Kolektive nr.01/B105 të datës 22.01.2021 të Arsimit në Kosovë. Duke u bazuar në thëniet e cekura më lartë e paditura kërkon që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e Punës me numër 171/3, e datës 13.10.2017, për paditësen e lëshuar nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, në Qendrën e Kompetencës në Prizren, si mësimdhënëse. Nga vërtetimi me numër të protokollit 6/14-2024, të datës 26.01.2024, gjykata ka vërtetuar faktin se Albнора Ajazaj është në marrëdhënie pune në Qendrën e Kompetencës në Prizren nga data 01.09.2015 dhe vazhdon ende. Bazuar në Listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditësit e që është shuma prej 459.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë

22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve” ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën 01 Korrik 2022 - 20 Nëntor 2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses ka qenë 459.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagë është 248.11 euro ($459.00 \times 11.6\% = 53.24 \times 4 \text{ muajt} = 212.97$), si dhe për 20 ditë të muajit nëntor ($53.24 \div 30 = 1.77 \times 20 \text{ ditë} = 35.49$ euro) apo në shumën e përgjithshme prej 248.11 euro.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 të LPK-së, ku parashihet që “po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”. ”, andaj ka vendosur si në pikën nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (13.11.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike, po ashtu gjykata ka vlerësuar edhe pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditëses por gjeti se ky pretendim është i pa bazuar për arsye se paditësja ka kërkuar kompensim nga data 01.07.2022 deri me datën 20.11.2022, ndërsa padia është paraqitur me datë 13.11.2023, prandaj nuk ka parashkrim të kërkesës sipas nenit 87 të Ligjit të Punës. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20.00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, përkatësisht për precizimin e padisë meqenëse kompensimi caktohet vetëm për shpenzimet e krijuara lidhur me lëndën në gjykatë. Për më

Numri i lëndës: 2023:258030

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05743800

teper nuk mund te kerkohet kompensim per secilen parashtrese te deponuar ne gjykatë e posaçerisht jo lidhur me parashtresen e dorëzuar per plotësimin e padisë, duke qene se parashtresa gjegjesisht padia fillestare ka pasur te meta.

Duke u bazuar ne te dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi ne pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe 152 te LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.4305/23, me datë 28.05.2024

B. profesional
Ali Kosova

Gjyqtarja
Edije Sezairi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër ketij aktgjykimi palët kanë te drejte ankese ne afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit, ne Gjykatën e Apelit ne Prishtinë, permes kesaj Gjykate.